



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TROPOJE

### ANALIZA E PUNES SE PROKURORISE PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TROPOJE PER VITIN 2016

Pas nje periudhe nje vjeçare ju paraqesim bilancin e punes se Prokurorise se Rrethit Gjyqesore Tropoje, te Prokuroreve dhe Oficereve te Policise Gjyqesore ne ushtrimin e ndjekjes penale per vitin 2016, duke pasqyruar ne menyre te plote treguesit e punes per kete vit, problemet e evidentuara, marredheniet e punes mes Prokuroreve dhe Oficereve te Policise Gjyqesore si dhe te stafit administrativ dhe marredheniet e punes me Drejtues te Sherbimeve te Policise Gjyqesore dhe Institucioneve te tjera si dhe prioritetet e punes se Prokurorise se Rrethit Gjyqesore Tropoje per vitin 2016.

Treguesit e punes se Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Tropoje per vitin 2016, jane si me poshte:

#### *Treguesit e pergjithshem te ndjekjes penale*

**Ne vitin 2016** Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Tropoje ka hyre me 89 procedime penale te mbartura ne hetim, me 13 persona nen hetim, me 37 te pandehur, me 20 te arrestuar dhe me masa sigurimi.

**Gjate vitit 2016** jane regjistruar 238 procedime penale me 33 persona nen hetim dhe 99 te pandehur nga te cilet 46 te arrestuar/ndaluar dhe masa sigurimi.

**Kane ardhë me transferim** 7 procedime penale me 3 te pandehur nder te cilet 2 me mase sigurimi arrest ne burg.

**Jane rifilluar hetimet** per 2 procedime penale te pezulluara gjateve viteve, per vepren penale te parashikuar nga neni 141/a dhe 189 te Kodit Penal.

**Gjithesej gjate vitit 2016**, kane qene ne hetim 336 procedime penale ne hetim.

**Gjate vitit 2016**, jane perfunduar hetimet per 303 procedime penale, me 29 persona nen hetim, me 133 te pandehur nder te cilet me 51 me masa sigurimi.

**Nga vitit 2016**, jane mbartur ne hetim 33 procedime penale me 16 persona nen hetim, nder te cilet 4 me mase sigurimi.

**Jane mbartur ne gjykim nga viti 2015,** 26 procedime penale me 28 te pandehur nga te cilet 9 me mase sigurimi.

**Gjithesej kane qene ne gjykim gjate vitit 2016,** 130 procedime penale me 158 te pandehur, nder te cilet 55 me mase sigurimi.

**Jane perfunduar ne gjykim,** 84 procedime penale me 99 te pandehur nga te cilet 41 me mase sigurimi.

**Kane mbetur ne gjykim,** 46 procedime penale me 59 te pandehur, nder te cilet 14 me mase sigurimi.

**Gjate perfaqesimit ne gjykim jane kerkuar nga prokuroret masa denimi si me poshte;**

Per 20 te pandehur eshte kerkuar denim me gjobe, per 2 te pandehur eshte kerkuar denim me kohen e paraburgimit, per 5 te pandehur eshte kerkuar denim ne minimumin e dispozites, per 18 te pandehur eshte kerkuar denim mesatare, per 53 te pandehur eshte kerkuar aplikimi i nenit 59 te Kodit Penal, per 1 çeshtje eshte kerkuar terheqja e akteve nga gjykata.

**Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesore ka dhene keto masa denimesh;**

Per 20 te pandehur gjykata ka dhene denim me gjobe, per 2 te pandehur ka dhene denim me kohen e paraburgimit, per 4 te pandehur ka dhene denim ne minimumin e dispozites, per 15 te pandehur ka dhene denim mesatare, per 55 te pandehur ka aplikuar nenin 59 te Kodit Penal, per 2 çeshtje ka dhene pafajesi, per 1 çeshtje ka vendosur kthimin e akteve prokurorit.

**Jane apeluar** 2 vendime te gjykates per per te cilat eshte kerkuar nje mase me e rende denimi dhe eshte bere 1 apelim kundershuese per lenjen ne fuqi te vendimit te gjykates. Per nje apelim vendimi gjykata ka vendosur prishjen e vendimit te gjykates se shkalles duke pranuar apelimin e prokurorit, ndersa per rastet tjera shqyrtimi gjyqesore nuk ka perfunduar.

**Jane pushuar hetimet per 62 procedime penale.**

Dosjet e pushuara kane qene kryesisht per vepra penale te parashikuara nga nenet 290/1, 275, 150, 151 te Kodit Penal. Duhet theksuar si problematike per dojset e pushuara se per shkak te largesise me Tiranen si dhe mungeses se shume eksperteve te fushave te ndryshme ne Tropoje shume here jemi te detyruara te rregjistrojme procedime penale te cilat qe ne momentin e rregjistrimit mund te konstatohet se veprimi ose mosveprimi nuk i ploteson elementet e vepres penale prsh sic jemi perpara rastit te shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugore, por per shkak te largesise dhe mungeses se eksperteve mjekoligjore jemi te detyruar te rregjistrojme procedimin penal pasi deri ne ardhjen e aktit te kekspertimit mjekoligjore kalojne afatet per te vendosur mosfillimin e procedimit penal. Po ashtu nje pjese e mire e procedimeve penale jane procedime te rregjistruara per vepra

penale qe ndiqen mbi bazen e ankimit te demtuarit te cilet me pas kane terhequr ankimin e bere nga ana e tyre.

### **Jane pezulluar hetimet per 128 procedime penale.**

Procedimet penale te pezulluara kane qene ne te shumten e rasteve procedime penale te rregjistruara per veprat penale te vjedhjes se pasurise kryesisht vjedhje te vogla banale, vepra penale te kultivimit te bimeve narkotike, si vepra penale te fallsifikimit te pasaportave apo leternjofitimeve ku ne te gjitha rastet dyshohet se autore te veprave penale jane shtetas kosovare dhe procedimet penale jane pezulluar ne pritje te administrimit te leterporosive nga autoritete gjyqesore kosovare.

Nga hetimi i ketyre procedimeve te pezulluara vlen te theksohet se kane ardhe dhe si pasoje e dobet e punes se seksionit te policise gjyqesore ne Komisaratin e Policise Tropoje. Vihet re se per veprat penale te “Vjedhjes dhe ”Kultivimit te bimeve narkotike”, policia gjyqesore seksioni i policise se shtetit, kryen veprimet e para ne vendngjarje dhe nuk vijon hetimet me kujdes per identifikimin e autoresise se vepres penale dhe mbledhjes se provave apo informacioneve per identifikimin e autoresise se ngajres. Po ashtu pas referimit te materialit ne prokurori dhe delegimit te dosjes penale per hetim verehet se veprimet e kryera nga policia gjyqesore jane me shume veprime per te kryer detyrat e lena nga prokurori dhe nuk i kushtohet kujdes hetimit te tyre per mbledhjen e provave dhe marrjen e informacioneve te cilat mund te ndihmojne ne gjetjen dhe administrimin e provave dhe autoresise se ngjarjes, duke rezultuar me deshtim te hetimeve ne nje numer shume te madh te procedimeve penale. Po ashtu shkak per deshtimin e hetimeve dhe pezullimin e ceshtjeve penale eshte edhe mungesa e oficereve te policise gjyqesore profesioniste dhe levizjeve shume te shpeshta te policise gjyqesore sidomos ne sektorin e krimeve te lehta ne komisariat.

### **Jane transferuar 7 procedime penale.**

Kryesisht procedimet penale te transferuara jane procedime me autore te mitur, per veprat penale te parashikuara nga nenet 291 dhe 134 i Kodit Penal dhe jane transferuar ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder, seksioni i hetimit te veprave penale me autore te mitur pasi ne prokurorine prane gjykates se shkalles se pare tropoje nuk ka seksion per hetimine veprave penale te kryera nga te miturit.

### **Kane mbetur ne hetim 33 procedime penale.**

Si rezultat i angazhimit te prokuroreve dhe oficereve te policise gjyqesore ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Tropoje eshte bere e mundur perfundimi ne kohe i procedimeve penale duke mbartur nje numer shume te vogel te procedimeve penale te cilat jane thuajse te gjitha procedime penale te filluara ne muajin e fundit apo te parafundit te vitit 2016.

Si problematike per sa ju perket vonesave ne hetimin dhe perfundimin ne kohe ne pergjithesi te procedimeve penale jane disa arsye.

**E para**, lidhet me numrin e madh te procedimeve penale te rregjistruar ne fundin e vitit 2016, sidomos procedime te ardhura nga dega e sigurimeve shoqerore per vepren penale te parashikuar nag neni 145 i Kodit Penal.

**E dyta**, nga mungesa e oficerave profesionaliste ne seksionin e policise gjyqesore prane Komisarariatit te Policise Tropoje dhe sidomos levizjeve te shpeshta te tyre gje qe ka sjelle per pasoje vonesa dhe mos hetimin e procedimeve penale ne kohe dhe me profesionalizem. Po ashtu rezulton se per shkak te levizjeve te shpeshta te oficerave te policise gjyqesore ka pase raste qe per te njetat procedime penale eshte bere zevendesimi i oficerave te policise gjyqesore ne afate te shkurtra kohore duke bere zgjatje te afateve hetimore per procedime penale.

**Eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal per 88 materiale kallezuese te rregjistruara si kallezime penale.**

Thkesojme se per shkak te faktit se deri ne periudhen e fund vitit 2016 nga Gjykata e Shkalles se Pare Tropoje nuk jane pranuar dergimi i materialeve kallezuese qe lidhen me veprat penale te fyerjes, shpifjes dhe rrahjes vepra penale qe ndiqen me ankimin e te demtuarit akuzues dhe nga gjykata nuk jane pranuar ato me pretendimin se e drejta per te vene ne levizje gjykatën i perket vetem te demtuarit akuzues, kemi qene te detyruar qe per keto materiale te vendosim mosfillimin e procedimit penal duke i vene ne dispozicion te demtuarit nje kopje te vendimit si dhe nje kopje te materialeve hetimore te cilet me pas kane paraqitur kerkesen per gjykim ne gjykate.

Po ashtu nje pjese e madhe e materialeve per te cilat eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal jane per vepra penale te shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugore, shkaterrimit te prones me zjarr ne rastet kur zjarri ka qene aksidental si pasoje e energjiise elektrike etj.

***Treguesit e masave personale te sigurimit.***

**Jane arrestuar ne flagrante** nga policia gjyqesore 46 te dyshuar per kryerjen e veprave penale.

**Jane ndaluar** me urdher te prokurorit 3 te dyshuar per kryerjen e veprave penale.

**Jane paraqitur ne gjykate** 49 kerkesa per vleresimin e arrestimit dhe caktimin e masave te sigurimit.

Per 20 te arrestuar eshte kerkuar masa e sigurimit personal “arrest ne burg”.

Per 2 te arrestuar eshte kerkuar masa e sigurimit “arrest ne shtepi”.

Per 1 te arretuar eshte kerkuar masa e sigurimit “garanci pasurore”.

Per 26 te arrestuar eshte kerkuar masa e sigurimit “detyrim per paraqitje ne policine gjyqesore”.

**Gjykata ka vleresuar te ligjshme** te gjitha arrestimet/ndalimet e te dyshuarve per kryerjen e veprave penale dhe ka caktuar masa sigurimi per te gjithë te arrestuarit/ndaluarit si me poshte;

Per 19 te arrestuar gjykata ka vendosur masen e sigurimit personal “arrest ne burg”.

Per 2 te arrestuar gjykata ka vendosur masen e sigurimit arrest ne shtepi.

Per 1 te arretuar gjykata ka vendosur masen e sigurimit garanci pasiuore.

Per 26 te arrestuar gjykata ka vendosur masen e sigurimit “detyrim per paraqitje ne policine gjyqesore”.

Per 1 te arrestuar ka vendosur masen e sigurimit “arrest ne burg” me afat.

Masat e sigurimit arrest ne shtepi, garanci pasurore dhe detyrim per paraqitje jane kerkuar per vepra penale te lehta si ato te parashikuara nga nenet 291, 137, 174, 242 etj.

Masat e sigurimit arrest me burg jane kerkuar dhe dhene nga gjykata per vepra penale te renda si ato te parashikuara nga neni 76, 283, 284, etj.

Duhet te theksohet se gjykata na ka mbeshtetur ne masat e sigurimit duke dhene masat e sigurimit sipas kerkesave te prokurorit te cilat kane qene kerkesa ne perputhje me kerkesat e Kodit te Procedures Penale.

Eshte bere apelim kundershues per nje vendim i gjykates per mase sigurimi dhe gjykata e apelit ka rrezuar kerkesen e te arrestuarit per zbutjen e mases se sigurimit duke vendosur sipas kerkeses se prokurorit, si dhe eshte apeluar nje vendim i gjykates qe ka venosur mase sigurimi me afat, per te cilen gjykata ka vendosur sipas kerkeses se prokurorit.

### **Treguesit statistikor te zgjatjes se afateve te hetimeve paraprake**

Gjate vitit 2016 jane zgjatur afatet deri ne 3 muaj per 26 procedime penale, me 32 persona nen hetim nder te cilet 22 me mase sigurimi.

Jane zgjatur afatet deri ne 6 muaj per 3 procedime penale me 6 persona, nder te cilet 2 me mase sigurimi.

Duhet theksuar se zgjatjet e afatit te hetimeve per nje numer shume te madh te procedimeve penale kane ardhë dhe per shkak te mos kryerjes ne kohe te veprimeve hetimore te mundshme dhe te nevojshme nga problematikat qe lidhen me levizjet e shpeshta te oficerve te policise gjyqesore ne seksionin e policise se shtetit, emerimit te oficerve jo profesioniste ne kete seksion, vonesat qe lidhen me administrimin e shkresave dhe kthimit te pergjigjeve nga institucionet e sidomos nga kompanite e telefonise celulare

si dhe nga mungesa e ekspeteve te gjitha fushave ne Rrethin Tropoje, si dhe administrimit me vonese sidomos te akteve te ekspertimit kimik te bimeve narkotike apo dhe armeve te zjarit te cilat per kane qene e domodoshme thujse ne çdo rast nderhyjra e drejtuesit te prokurorise, prane titullareve te Drejtorise se Policise Shkencore.

### **Treguesit statistikor te Marredhenieve Juridiksionale me Jashte**

Gjate vitit 2016 jane trajtuar dy raste te ekstradimeve per jashte shtetit, te cilat ne te dy rastet kane qene shtetas kosovare te shpallur ne kerkim nderkombetare. Jane paraqitur kerkesat per dy ekstradime ne gjykate, e cila ka pranuar ekstradimin ne te dy raste e paraqitura.

Jane paraqitur per ekzekutim 21 leterporosi nga jashte shtetit te cilat ne te shumten e rasteve jane leterporosi te autoriteteve gjyqesore te kosoves, per njoftimin e akteve shtetasve shqiptare dhe jane ekzekutuar te gjitha leterporosit duke ju komunikuar aktet personave sipas kerkeses per ndihme juridike.

Eshte paraqitur nje kerkese per njohjen e vendimit penal te huaj, paraqitur me leterporosi nga autoritetet gjyqesore te kosoves dhe gjykata ka pranuar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal te huaj.

### **Treguesit statistikor te ekzekutimit te vendimeve penale ;**

Jane nxjerre nga Prokuroria urdherat e ekzekutimit te vendimeve penale per 21 te denuar me burgim, per 20 te denuar me gjobe dhe 50 te denuar me burgim per te cilet eshte aplikuar neni 59 i Kodit Penal.

Gjate vitit 2016 rezulton te jene ekzekutuar vendimet penale per 21 te denuar me burgim, per 70 te denuar me gjobe dhe 54 te denuar me burgim per te cilet eshte aplikuar neni 59 i Kodit penal.

Kane mbetur te pa ekzekutuara nga vitit 2016, 2 vendime denimi me burg dhe 3 vendime denimi me gjobe.

Kane mbetur te pa ekzekutuara te mbartuara nga vitete e meparshme 19 denime penale me burgim.

Gjithesej kane mbetur te pa ekzekutuara 21 denime me burg dhe 3 denime me gjobe.

Rezulton se gjate vitit 2016, ka pase nje permiresim te punes ne ekzekutimin e vendimeve penale nga Zyra e Sherbimit te Proves Tropoje dhe Zyra e Permbarimit Gjyqesore Tropoje, ndersa vendimet penale te denimit me burgim te mbartuara nga vitet vijon te jete nje numer shume i vogel i ekzekutimit te tyre.

### **Treguesit statistikor te pergjithshem per prokuroret;**

**Drejtuesi i Prokurorise Artur Ismajlukaj**, gjate vitit 2016 ka hetuar gjithesej 78 procedime penale, nga te cilat ka vendosur dergimin per gjykim per 35 procedime penale, ka vendosur pezullimin e hetimeve per 21 procedime penale, ka vendosur pushimin e hetimeve per 17 procedime penale, ka vendosur transferimin e hetimeve per 5 procedime penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal per 15 materiale kallezuese dhe ka mbartur ne hetim 7 procedime penale.

**Prokurori Agim Dalipi**, gjate vitit 2016 ka hetuar gjithesej 87 procedime penale, nga te cilat ka vendosur dergimin per gjykim per 17 procedime penale, ka vendosur pezullimin e hetimeve per 32 procedime penale, ka vendosur pushimin e hetimeve per 25 procedime penale, ka vendosur transferimin e hetimeve per 1 procedime penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal per 1 materiale kallezuese dhe ka mbartur ne hetim 12 procedime penale.

**Prokurori Artan Shtrungza**, gjate vitit 2016 ka hetuar gjithesej 80 procedime penale, nga te cilat ka vendosur dergimin per gjykim per 25 procedime penale, ka vendosur pezullimin e hetimeve per 25 procedime penale, ka vendosur pushimin e hetimeve per 17 procedime penale, ka vendosur transferimin e hetimeve per 1 procedime penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal per 15 materiale kallezuese dhe ka mbartur ne hetim 5 procedime penale.

**Oficeri i policise gjyqesore Elton Hoxha**, gjate vitit 2016 ka hetuar gjithesej 74 procedime penale, nga te cilat ka sugjeruar dergimin per gjykim per 20 procedime penale, ka sugjeruar pezullimin e hetimeve per 11 procedime penale, ka sugjeruar pushimin e hetimeve per 17 procedime penale.

**Oficeri i policise gjyqesore Bujar Madani**, gjate vitit 2016 ka hetuar gjithesej 78 procedime penale, nga te cilat ka sugjeruar dergimin per gjykim per 10 procedime penale, ka sugjeruar pezullimin e hetimeve per 22 procedime penale, ka sugjeruar pushimin e hetimeve per 7 procedime penale.

**Nga seksioni i policise gjyqesore te policise se shtetit** ne komisariatit e policise tropoje jane hetuar gjithesej gjate vitit 2016 123 procedime penale

Nga te dhenat statistikore rezulton se rreth 50% e procedimeve penale jane hetuar nga oficeret dhe prokuroret ne Prokurorine Prane Gjykates se Shkalles se Pare Tropoje dhe 50% e punes nga policia gjyqesore prane Komisariati te Policise Tropoje.

Po ashtu rezulton se gjate vitit 2016 ka pase nje renie te lehte te nurmit te procedimeve penale dhe kallezimeve penale te rregjistruara.

Verehet se ka nje shtim te procedimeve penale ne fushen e vjedhjes se energjise elektrike, shkeljes e rregullave te qarkullimit rrugore, kultivimit te bimeve narkotike, mashtrimit me sigurimet, ndersa veprat penale kunder jetes dhe shendetit, vjedhjes se pasurise, kane pase renie te procedimeve penale te rregjistruara.

Per sa i perket ngarkeses se punes Prokuroreve dhe Oficereve te Policise Gjyqesore procedimet penale jane ndare ne menyre te drejte duke patur parasysh veshtiresine dhe volumen e punes se tyre si dhe procedimet per vepra penale te renda.

Gjate periudhes njevjeçare nga drejtuesi i prokurorisë nuk ka pasur raste te shfuqizimit te vendimeve te prokuroreve ose ushtrimit i apelimeve per vendime te themelit, ku eshte perfaqesuar akuza nga Prokuroret e kesaj Prokurorie.

Eshte shfuqizuar nga Prokuroria e Pergjithme nje procedim penal i cili vijon te jete ne hetim.

Persa i perket stafit ne pergjithesi ju eshte kerkuar nje zbatim me korrektesi i disiplines ne pune dhe etikes se tyre gjate ushtrimit te detyres. Gjithashtu per gjithe urdherat dhe udhezimet e Prokurorit te Pergjithshem te ardhur ne Prokurori, jane njohur me to te gjithe punonjesit, konkretisht Prokuroret dhe Oficeret e Policise Gjyqesore.

Per sa i perket pageses se gadishmerise dhe te mbikohes se punes, per Prokuroret, Oficeret e Policise Gjyqesore keto jane perlllogaritur sipas raportit te mbajtur per oret e punes jashte orarit zyrtare te punes ne zbatim te urdherit te Prokurorit te Pergjithem per pagesen e sherbimit te gatishmerise.

### ***Problematika qe lidhen me vonesat e hetimeve.***

Nje pjese te problematikave per arsytet e vonesave ne perfunimin e ceshtjeve penale ne kohe dhe me cilesi rezulton se problematike tjeter e vonesave te hetimit po ashtu duhet saruar se vonesat e hetimeve shume here vijne si shkak i vonesave te kthimit te pergjigjeve e sidomos pergjigjet e tabulateve te telefonatave nga kompanite celulare te cilat shume here vonojne kthimin e pergjigjeve deri ne dy muaj dhe me shume duke u bere pengese ne hetimin me cilesi te procedimeve penale, pervec faktit se jane shkak i vonesave ne perfundimin e procedimeve penale.

Po ashtu mungesat e theksuara te eksperteve ne Rrethin Tropoje behen shkak i vonesave te hetimeve, pasi rezulton se i vetmi ekspert i licensuar ne Rrethin Tropoje eshte eksperti mjekoligjore i cili dhe ai perpilon aktet e ekspertimit vetem kur demtimet e personave jane te lehta por nuk kryen ne asnje rast autopsine e viktimave.



## **Problematikat me seksionin e policise gjyqesore prane Komisarariatit te Policise Tropoje.**

Vihet re se ne seksionin e policise gjyqesore ne Policine e shtetit ka akoma mungesa ne organiken e saje sidomos mungesa e vazhdueshme prej shume vitesh e zyres se oficerit te policise gjyqesore, si dhe mungesa e oficerëve profesioniste e cila ne shume raste eshte bere shkak edhe per zvarritjen e hetimeve dhe moszbulimin e autoresise se veprave penale. Po ashtu eshte shume problematike levizja e shpeshte e oficerëve te policise gjyqesore ne seksionin e policise gjyqesore ne policine e shtetit qe sic e kemi cituar me siper eshte bere pengese ne hetimin e shpejte te procedimeve penale si dhe ne cilesine e hetimit.

Per sa siper kerkohet nje vemendje me e madhe e drejtuesve te policise per sa i perket plotesimit te organikave dhe mundesise qe levizjet e oficerëve te policise gjyqesore te jene sa me te kujdeshme gjithmone ne interes te ushtrimit me efikasitet te ndjekjes penale.

Po ashtu duhet theksuar se policia gjyqesore prane Komisarariatit te Policise Tropoje ka perballuar nje volum shume te madh pune, nisur dhe nga aksionet e policise se shtetit kunder disa fenomeneve si ajo e kultivimit te bimeve narkotike, drejtimit te automjeteve pa deshmia aftesie, vjedhejes se energjise elektrike, organizimit te llotarive te paligjshme.

Po ashtu duhet theksuar se prokuroret kane pase nje bashkepunim te mire dhe korrekt institucional dhe ligjore me drejtuesit e policise ne rreth si dhe me drejtuesit e policise ne qark nga te cilet kemi gjetur bashkepunim dhe mirekuptim shume te mire dhe fale bashkepunimit, komunikimeve dhe mirekuptimit te vazhdueshem mes prokurorore dhe drejtuesve te policise eshte bere e mundur qe problematikat e mesiperme te minimizohen dhe te arrihen suksese gjate punes se perbashket ne hetimin e çeshtjeve penale.

Po ashtu duhet theksuar se eshte verejtur nje kerkese llogari shume me e madhe nga drejtuesit e policise e sidomos nga Drejtuesit e Policise se Qarkut Kukës ndaj oficerëve te policise gjyqesore te seksionit te policise se shtetit ne Komisariatin e Policise Tropoje, vemendje qe ka sherbyer ne permiresimin e punes nga ky seksion i policise gjyqesore

Gjate periudhes njevjeçare nga Prokurori i Rrethit nuk ka pasur raste te shfuqizimit te vendimeve te Prokurorve ose ushtrimi i apelimeve per vendime te themelit, ku eshte perfaqesuar akuza nga Prokuroret e kesaj Prokurorie. Persa i perket stafit ne pergjithesi ju eshte kerkuar nje zbatim me korrektesi i disiplines ne pune dhe etikes se tyre gjate ushtrimit te detyres.

Gjithashtu per gjithë urdherat dhe udhezimet e Prokurorit te Pergjithshem te ardhur ne Prokurori, jane njohur me to te gjithë punonjesit, konkretisht Prokuroret dhe Oficeret e Policise Gjyqesore, si dhe stafi administrativ i Prokurorise.

Per sa i perket marredhenieve me drejtues te institucioneve te tjera si gjykate, polici, ato kane qene korrekte ne sherbim te mbarevajtjes se punes dhe marredhenieve nderinstitucionale ku kjo duket qarte edhe ne rezultat e treguesve te punes njevjeçare.

### **Informacion mbi administrimin e prokurorise.**

Gjate vitit 2016, ka pase zbatim te rregullt te buxhetit dhe shpenzimeve te cilat ne çdo rast jane dokumentuar me urdherat perkatese, krijimin e komisioneve te prokurimit, urdher xhirime, urdhera pe hyrjen dhe daljen e te gjitha burimeve dhe materialeve ne prokurori.

Per sa i perket komunikimit me mediat nuk kemi pase raste interesimi te tyre, ndersa per sa i perket pjeses se informimit te publikut, te gjitheshtetasi e interesuar kane marre informacionin e duhur ne nje kohe shume te shpejte, pa vonesa me shkrim por dhe verbalisht dhe nuk ka pase ankesa per sa siper.

Rregjistrat dhe raportet jane mbajtur rregullisht nga drejtesi i prokurorise dhe zyra e sekretarise dhe rregjistrat, si dhe kemi pase nje perdorim te rregullt te sistemit CAMS.

Gjate punes nga te gjitheshtetasi i prokurorise dhe oficerave te policise gjyqesore por dhe pjeses se administrates ka pase nje respektim rigoroz te disiplines ne pune dhe etikes dhe nuk kemi patur problematika per sa me siper.

### **Prioritetet e punes per vitin 2017**

Per sa i perket vitit 2017, prioritetet kryesore te punes sone do te perqendrohen per te perfunduar sa me shpejt procedimet e mbartura nga viti i kaluar brenda afatit te hetimeve, si dhe hetimi ne kohe te shpejte dhe me cilesi e procedimeve penale gjate vitit 2017.

Prioritet i punes tone pervec te tjerave gjate vitit 2017, ne do jete rritja e efektivitetit te punes dhe ndjekjes penale per vepra penale te krimin ekonomik dhe korrupsionit, trafikave te paligjshme, prodhimit dhe shitjes se narkotikeve, kultivimit te lendeve narkotike si dhe per veprat penale te tjera si vrasje, shkelje e rregullave te qarkullimit rrugor, etj.

Po ashtu nje kujdes me i madh do i kushtohet mbikqyerjes se ekzekutimit te vendimeve penale si ato me burgim te mbartura nga vitet e kaluara, te cilat gjate vitit 2016 jane ekzekutuar ne numer te paket.

**DREJTUESI I PROKURORISE**

**ARTUR ISMAJLUKAJ**